

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Primer-11 W

PRAJMER ME BAZË RRËSHIRE SINTETIKE PËR PËRGATITJEN E SIPËRFAQEVE PREJ GIPSI OSE ÇIMENTOJE

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Primer-11 W është prajmer me bazë kopolimeresh organike dhe aditivësh të posaçëm në emulsion uji, i cili përdoret si veshje bazë për nënshtresat me bazë çimentoje dhe suvatë, pllaka gipsi ose suvaje, llaçe ahnidriti ose beton.

PËRDORIMET

- Trajtim për nënshtresat e gipsit ose suvasë mbi të cilat do të aplikohen në vijim kollat ose llaçet me bazë çimentoje
- Trajtim për sipërfaqet e llaçeve të çimentos shumë absorbues ose suvatë përpara aplikimit të kollave me bazë çimentoje, llaçeve apo përbërësve të vetënivelueshëm.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Emulsion uji
- Prajmer për nënshtresat absorbuese
- Përmirësim i ndërkapjes me nënshtresën

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	emulsion uji
Ambalazhi	enë 5 kg
Paraqitja / Ngjyra	lëng i kuq
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur, në kushte të thata dhe të freskëta.
Dendësia	~1.01 kg/l

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	100–200 g/m ² në varësi të absorbueshmërisë së nënshtresës.
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +35 °C max.
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +35 °C max.
Koha e pritjes / mbiveshja	~ 2 orë. Produkti i aplikuar nuk duhet të jetë i ngjitshëm përpara aplikimit vijues.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Sika® Primer-11 W aplikohet mbi nënshtresa absorbuese, si nënshtresat me bazë çimentoje, nënshtresa gipsi dhe anhidriti ose mbi pllaka gipsi. Lagështia e mbetur mbi sipërfaqet e përmendura më sipër të gipsit duhet të jetë më pak se 0.5 %, përpara aplikimit të produktit.

APLIKIMI

Aplikoni Sika® Primer-11 W me furçë, furçë të sheshtë ose rul derisa sipërfaqja të jetë mbuluar plotësisht. Zonat e patrajuara do të shihen me lehtësi falë ngjyrës së kuqe të produktit. Sika® Primer-11 W nuk formon cipë mbi sipërfaqen. Në rast nënshtresash me absorbueshmëri të ulët, holloni Sika® Primer-11 W me ujë në raport max. 1:1.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me ujë. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Aplikoni vetëm mbi nënshtresa të thara.
- Mos e përdorni për konsolidimin e nënshtresave të çimentos

Mos aplikoni Sika® Primer-11 W:

- Mbi metal, vinil, dru, sipërfaqe dysHEMEJE qeramike, blloqe betoni
- Mbi sipërfaqe jo absorbuese
- Mbi nënshtresa që janë subjekt lagështie
- Në ambiente të jashtme

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Primer-11 W

Shkurt 2019, Botimi 01.01

020815120010000007

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaPrimer-11W-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf